

Invaliditeti

Kush nuk punon gjatë për arsye shëndetësore apo mund të punoj vetëm pjesërisht, ka sipas rrethanave të drejtën për mbështetje financiare përmes sigurimit invalidor (IV). IV nuk paguen vetëm para. Ai i mbështet të siguruarit para s`gjithash te hyrja apo rihyrja në punë.

Sigurimi invalidor

Sigurimi invalidor (IV) është institucion i shtetit. Shumica e personave të rritur duhet për këtë të paguajnë shuma. Shumat zbriten prej të punësuarve çdo muaj prej rrogës, punëdhësi merr përsipër gjysmën. Të pavarurit apo personat pa vend pune duhet në filialen e komunës në zyrën për sigurimit sociale (Gemeindezweigstelle der Sozialversicherungsanstalt, SVA) të njoftohen, si duhet t`i paguajnë shumat e tyre.

Mbështetja përmes sigurimit invalidor

Të drejtë për mbështetje nga IV kanë personat, që më s`paku një vit shkaku i arsyeve shëndetësore (psiqike apo fizike) nuk kanë punuar fare apo vetëm pjesërisht. IV paguan në formën e një pensioni mujor. Mirëpo kjo bëhet vetëm atëherë, kur të siguruarit shkaku i kufizimeve nuk mundën më të riaftësohen për punë. IV mbështet personat invalid, që ta gjejnë një punë të përshtatshme. Mbështetje përmes IV duhet të aplikohet në komunat në zyrën për sigurime social.

Shërbimet shtesë

Personat, të cilët megjithë mbështetjes nga IV kanë pak para për të jetuar, kanë sipas rrethane të drejtën për shërbime shtesë financiare (Ergänzungsleistungen). Për këtë duhet të aplikohet në zyrën për sigurim social. Është qartë e rregulluar kush e gëzon të drejtën për shërbimet shtesë. Shërbimet shtesë financohen nga tatim pagueset dhe tatim paguesit.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/siguria-sociale/invaliditeti